



*“Dokumentet ligjore të huaja të cituara në opinionet kushtetuese të  
Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara”*

Një bashkëbisedim ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë të SHBA,

Antonin Scalia dhe Stephen Breyer

(13 Janar 2005)

**Dorsen:** Ky është një bashkëbisedim ndërmjet dy gjyqtarëve drejtues të Gjykatës së Lartë që ne mezi presim ta dëgjojmë. Jam i sigurt se do të bashkëpunojmë të gjithë që Scalia të jetë Scalia dhe Breyer të jetë Breyer, me shumë pak Dorsen. Do të parashtrojmë disa pyetje: Kur ne bisedojmë rreth përdorimit të vendimeve të gjykatave të huaja në rastet kushtetuese të SHBA-ve, çfarë organi ligjor të huaj kemi parasysh? Kufizohemi vetëm tek ligji i huaj kushtetues, apo edhe në ligjet e tjera? Po në lidhje me praktikat gjyqësore që rrjedhin nga vendime të mëparshme gjyqësore? Po në lidhje me rastet që përfshijnë ligjin ndërkombëtar, siç është interpretimi i traktateve? Pra, në përgjithësi, a është e përshtatshme për gjyqtarët tanë, të përdorin dhe të citojnë materiale të huaja gjatë procesit të vendimmarrjes për rastet kushtetuese? Nëse është kështu, a tenton kjo praktikë të dobësojë anën unike të eksperiencës kushtetuese amerikane? Apo kjo praktikë i thëllon burimet për vendimmarrjen kushtetuese dhe për pasojë, e forcon atë? Kështu,, unë u lutem të ftuarve tanë të shquar që, të përgjigjen për ndonjë, ose për asnjë nga këto çështje, si dhe të bëjnë çfarëdo komentesh që ata dëshirojnë gjatë bashkëbisedimit të tyre.

**Scalia:** Mirë, shumica e këtyre pyetjeve duhet t'i drejtohen Gjyqtarit Breyer, sepse unë nuk e përdor ligjin e huaj në interpretimin e Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara. [të qeshura.] Unë do ta përdorja atë në interpretimin e traktateve. Por ju jeni duke folur për përdorimin e ligjit të huaj për të përcaktuar përmbajtjen e ligjit kushtetues

amerikan, për të qenë të sigurt se jemi në rrugën e duhur dhe kemi të njëjtin moral e kuadër ligjor, si dhe pjesa tjetër e botës. Por, ne nuk kemi të njëjtin moral dhe kuadër ligjor si pjesa tjetër e botës dhe kurrë nuk do të kemi. Nëse ju do t'u thoshit hartuesve të Kushtetutës se ne do të bëhemi njësoj si Evropa, ata do të ishin tmerruar. Nëse ju do të lexonit serinë e artikujve dhe eseve të shkruara për të promovuar ratifikimin e Kushtetutës së SHBA-ve, ato janë plot me deklarata që e bëjnë shumë të qartë se hartuesit e Kushtetutës nuk kishin të gjithë shumë respekt për mjaft nga ligjet në vendet Evropiane. Madisoni, për shembull, flet me përçmim për vendet e Evropës kontinentale, “të cilat kanë frikë që të lejojnë popullin e tyre të mbajë armë. Ose, le të marrim jurisprudencën tonë të abortit. Ne jemi një prej gjashtë vendeve të botës që e lejojmë abortin me kërkesë në çdo kohë, përpara se fetusin të ndjehet gjallë. Duhet ta ndërrojmë ne këtë, sepse vendet e tjera mendojnë ndryshe? Ose, ndoshta një pyetje më e drejtpërdrejtë: pse nuk e kemi ndërruar këtë, nëse nevojitet që Gjykata të mendojë se ne duhet të bindemi prej ligjit të huaj? Ose a e përdorim ne ligjin e huaj në mënyrë selektive? Në rastet kur ligji i huaj e aprovon atë që dëshiron të thotë gjyqtari për rastin, atëherë ne e përdorim ligjin e huaj, ndërsa kur ai nuk e aprovon, ne nuk e përdorim. Kështu, ne e citojmë ligjin e huaj në rastin e Lawrence<sup>1</sup>, rasti mbi marrëdhëniet homoseksuale. Por ne nuk kemi thënë as edhe një pëshpërimë për ligjin e huaj në një seri rastesh për abortin.

Çfarë po ndodh? A doni ju që ligjet e huaja të kenë fuqi? Unë dyshoj nëse ndokush do të thoshte: “po, ne duam të qeverisemi nga pikëpamjet e të huajve.” Nëse nuk duam që ligji i huaj të ketë fuqi, atëherë cili është kriteri për ta cituar atë? Që ky ligj të bjerë dakord me ty? Sepse unë nuk di ndonjë kriter tjetër për ta parashtruar. Kështu që, kjo nuk i jep përgjigje asnjë prej pyetjeve tuaja, por kjo ishte ajo që unë dëshiroja të thoja [të qeshura.]

**Dorsen:** Faleminderit. Është radha e Gjyqtarit Breyer.

**Breyer:** Unë mendoj se asistenti im ligjor ka gjetur një rast kur Gjyqtari Scalia i është referuar ligjit të huaj. [Të qeshura.] Në çdo rast, unë së pari dëshiroj t'ju falënderoj ju që na ftuat. Unë mendoj që edhe Gjyqtari Scalia beson se Shtetet e Bashkuara ndryshojnë nga disa vende të tjera në atë që, ligji këtu nuk shpallet si një vendim që merret nga lart, as edhe nga Gjykata e Lartë. Ligji del nga një proces kompleks,

---

<sup>1</sup> Lawrence et al. kundër Texas, 539 U.S. 558 (2003).

interaktiv, demokratik. Ne gjyqtarët luajmë një rol të kufizuar në këtë proces. Por ne jemi pjesë e këtij procesi. Kështu janë edhe avokatët, profesorët e drejtësisë, studentët dhe qytetarët e thjeshtë. Procesi mbledhet së bashku dhe vjen si një lloj bashkëbisedimi. Ky bashkëbisedim ndodh ndërmjet gjyqtarëve, ndërmjet profesorëve, ndërmjet anëtarëve të shoqatës së avokatëve, ndërmjet atyre që vendosin për rastet, ndërmjet atyre të cilët analizojnë dhe nxjerrin përfundime nga një sërë vendimesh, ndërmjet atyre që kanë eksperiencë praktike në drejtësi. Ligji del nga ky proces kompleks i shkëmbimit të mendimeve, dhe ne gjyqtarët marrim pjesë kur vendosim për rastet, ose kur flasim për ligjin dhe për vetë procesin e vendimmarrjes.

Unë mendoj se është e rëndësishme që ne t'u drejtohem dhe të flasim me grupet profesionale rreth këtyre çështjeve. Ne nuk njihemi mirë nga publiku i gjerë. Në çdo dhjetë raste që dikush më pyet mua "A jeni ju një anëtar i Gjykatës së Lartë?" në nëntë prej tyre ai që më drejtohet mendon se unë jam Gjyqtari Souter.

**Scalia:** Dhe ai ka rënë dakord me këtë.

**Breyer:** Po. T'i kthehem çështjes kryesore. Në shumë aspekte Gjyqtari Scalia dhe unë do të binim dakord me mënyrën se si ligji i huaj mund dhe duhet të influencojë në vendimet gjyqësore në Gjykatën e Lartë të Shteteve të Bashkuara, si dhe në gjykatat e tjera gjithashtu. Unë do i diskutoj raste të tilla më vonë, shpesh duke përfshirë çështje rutinë. Por në fillim le të përshkruajmë rastet më të debatueshme, për të cilat ka shumë gjasa që ne nuk biem dakord.

Shembulli më i mirë doli gjatë një seminari ku shumë profesorë, një anëtar i Kongresit, një senator, një tjetër gjyqtar dhe unë po diskutonim marrëdhëniet ndërmjet degëve të qeverisjes. Anëtari i Kongresit filloi të kritikonte përdorimin nga Gjykata e Lartë të ligjit të huaj në vendimet e saj. Fillimisht, unë nuk isha i sigurt se çfarë kishte ai në mendje. Pas pak kohe kuptova se ai ishte duke diskutuar çështjen për të cilën Gjyqtari Scalia dhe unë nuk biem dakord. Unë thashë: "Mirë, kritika jote duket se më kishte mua për qëllim." Pra bëhet fjalë kur unë i referohem ligjit të huaj në rastet kur përfshihet një çështje kushtetuese. Unë e kuptoj shumë mirë se vendimet e gjykatave të huaja nuk janë detyruese për gjykatat Amerikane. Sigurisht që nuk janë. Por, i thashë një anëtari të Kongresit, "Nëse unë kam një rast të vështirë dhe një qenie njerëzore e quajtur gjykatës, megjithëse nga ndonjë vend tjetër, është marrë me një problem të ngjashëm, pse nuk

duhet të lexoj se çfarë ka thënë ky gjykatës? Nuk është detyrues për mua, por unë mund të mësoj diçka. Anëtar i Kongresit u përgjigj, “Në rregull. Ke të drejtë. Lexoje. Thjesht mos e cito në opinionin tënd.” [Të qeshura.]

Unë shkova më tej dhe shtova, “Le të jem pak më i sinqertë. Në disa vende të huaja, njerëzit janë duke u përpjekur që të ngrenë institucione që do t’i ndihmojnë ata të mbrojnë demokracinë dhe të drejtat e njeriut, pavarësisht nga tradita e qeverisjes të mëparshme jo-demokratike apo shtypëse. Ata duan të demonstrojnë rëndësinë e ekzistencës së gjyqtarëve të pavarur që zbatojnë kushtetushmërisht mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Gjykata e Lartë e Shteteve të Bashkuara ka prestigj në këtë fushë. Gjykata të huaja u referohen vendimeve tona. Dhe nëse ne, ngandonjëherë, u referohemi vendimeve të tyre, referimi mund t’i ndihmonte këto institucione që po përpiqen. Referencat tregojnë që ne i lexojmë dhe jemi të interesuar në reagimet e tyre për probleme të ngjashme ligjore”.

Për shembull, në rastin kur unë mora pozicionin që Dispozita e Sistemit Fetar ndaloi përdorimin e gjerë të shkollimit me pagesë<sup>2</sup>, unë duhet të përballesh me faktin se në vende me tradita pak a shumë të ngjashme të ndarjes së kishës nga shteti, qeveritë subvencionojnë arsimimin në shkolla fetare. Shumica e qytetarëve të këtyre vendeve, për shembull në Britani dhe Francë, besonin se kjo nuk shkakton ndonjë dëm. Duke iu referuar rasteve, praktikave dhe pikëpamjeve të tilla do të thotë punë shtesë, megjithëse shumica e Gjykatës sonë e bën një gjë të tillë vetëm me raste. Ne e kuptojmë se nuk jemi ekspertë në çështje të tilla. Por besojmë se ia vlen, që nëse e bëjmë këtë ngandonjëherë të hapen sytë. Dhe kjo është ajo që unë do t’u thosha atyre që shqetësohen rreth vlefshmërisë së kësaj praktike. Praktika përfshin hapjen e syve tuaj se çfarë ndodh në vende të tjera, të marrësh atë që ti mëson për çka është e vlefshme dhe ta përdorësh atë si një pikë krahasimi, në mënyrë ndihmuese.

---

<sup>2</sup> Dispozita e Sistemit Fetar, që është në Amendmentin e I-rë të Kushtetutës së SHBA-ve, thotë “Kongresi të mos bëj ligje që të respektohet një sistem fetar, ose që prej tyre të ndalohet ushtrimi i lirë; ose që e kufizojnë lirinë e fjalës, ose të shtypit; ose të drejtën e njerëzve për tu mbledhur paqësisht, apo ti bëjnë peticion Qeverisë për ndonjë korrigjim apo ankesë.” Gjykata e Lartë vendosi në 2002 që ishte kushtetuese për qeveritë e shteteve që të ngrinin sistemin e shkollimit me pagesë për të përdorur paratë e taksapaguesve për të ndihmuar fonde private, ose shkolla fetare. Zelman kundër Simmons-Harris, 536U.S. 639 (2002).

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, për shembull, ka vendosur për një rast të quajtur Bowman<sup>3</sup>, rast i cili përfshinte një ligj që kufizonte kontributet e fushatës, si dhe një dispozitë të Kartës që e mbronte lirinë e shprehjes. Të dyja palët që i referoheshin këtij opinioni paraqitën në Gjykatën e Lartë një rast financimi fushate. Unë e lexova rastin. Nuk jam i sigurt se cilën anë ky opinion ndihmonte, por jam i kënaqur që juristët e referuan, sepse unë mësova diçka në lidhje me të. A mund të lexoj unë shumë raste të huaja gjatë punës sime? Jo shumë, sepse kjo të konsumon kohë. A duhet të njihem unë me ekzistencën e rasteve të huaja që përfshijnë çështje shumë të ngjashme me çështjen që ke në dorë? Unë besoj se po. Në lidhje me përdorimin e ligjit të huaj, unë do të thosha se, e kuptoj që një gjykatës nuk mund të lexojë çdo gjë. Por nëse juristët gjejnë një rast të huaj interesant dhe të dobishëm, dhe nëse ata i referohen atij rasti, gjyqtarët duhet ta lexojnë atë, duke e përdorur si ushqim për të menduar dhe jo si një precedent që të detyron.

**Dorsen:** Gjyqtari Scalia?

**Scalia:** Unë nuk e di çdo të thotë të shprehësh besim se, gjyqtarët do të bëjnë atë që duhet të bëjnë, pasi të kenë lexuar ligjin e huaj. Problemi im është se nuk e di çfarë është ajo që ata duhet të bëjnë.

Pse ligji i huaj do të kishte lidhje me atë që bën një gjykatës Amerikan kur ai interpreton, dhe nuk shkruan Kushtetutën? Sigurisht, hartuesit e kanë përdorur shumë ligjin e huaj. Nëse do të lexoni serinë e artikujve dhe eseve të shkruara për të promovuar ratifikimin e Kushtetutës së SHBA-ve, ato janë plot diskutime mbi sistemin zviceran, sistemin gjerman, etj. Ka plot nga këto diskutime, sepse krahasimi me praktikën e vendeve të tjera është shumë ndihmues në hartimin e një kushtetute. Po a është ndihmues edhe në interpretimin e saj?

Teoria ime se çfarë duhet bërë kur interpretojmë Kushtetutën Amerikane është që, të përpiqemi të kuptojmë se çfarë kuptimi kishte, se si e ka kuptuar shoqëria se çfarë do të thoshte Ajo, në kohën kur është adoptuar. Unë nuk mendoj se kjo ka ndryshuar qysh atëherë. Kjo qasje ka qenë qasja sipas rregullave deri rreth gjashtëdhjetë vjet më parë. Çdo gjykatës do t'ju kishte thënë juve se, kjo është ajo që duhet bërë. Nëse ju keni këtë filozofi, është e qartë që ligji i huaj nuk është i përshtatshëm, por me përjashtim të ligjit

---

<sup>3</sup> Bowman kundër Mbretërisë së Bashkuar, 26 Eur. Ct. H.R. Rep. 1 (1998).

të vjetër anglez. Frazja të tilla si “*due process* (ruajtja e të drejtave nga mohimi arbitrar i qeverisë ...),” dhe “*right of confrontation* (e drejta për ballafaqim)” janë marrë nga ligji anglez, dhe përmbajtja e tyre u kuptua ashtu siç do të thoshte atëherë. Kështu, unë e përdor ligjin e huaj më shumë se kushdo në Gjykatë. Por është i gjithë ligji i vjetër anglez. Për dikë që ka teorinë time të interpretimit do të ishte e lehtë të kuptonte se pse ligji i huaj është i pavend. Kështu që, Gjyqtari Breyer nuk do të ma kthente kurrë mendjen.

**Dorsen:** Po supozoni që ligji i vjetër anglez ju thotë juve se si një dispozitë duhet interpretuar në dritën e kushteve të kohës, siç ka qenë për shembull Dispozita e Tregtisë<sup>4</sup>?

**Scalia:** Po gjetët një ligj të vjetër anglez që e thotë këtë, atëherë unë do ta përdor atë. Por më lini të vazhdoj. Kjo është qasja ime në interpretimin e Kushtetutës. Gjyqtari Breyer nuk e ka qasjen ime. Ai zbaton parimin që Gjykata adoptoi rreth gjashtëdhjetë e ca vite më parë, fillimisht në fushën e Amendamentit të Tetë (dënimet mizore dhe të pazakonta) dhe pastaj edhe tjetërkund, nocionin që Kushtetuta nuk është statike. Kjo nuk nënkupton atë për të cilën njerëzit votuan kur u ratifikua, por që ajo ndryshon nga epoka në epokë. Në lidhje me këtë, po citoj një prej rasteve tona, “evolimin e standardeve të njerëzimit që shënojnë progresin e një shoqërie të pjekur.” Unë e hedh poshtë me neveri këtë frazë, sepse unë kam frikë se shoqëritë jo gjithmonë piqen. Ngandonjëherë ato kalben. Çfarë ju bën ju të mendoni se historia njerëzore është si një aeroplan i prirur të shkojë vetëm lart, se çdo ditë, në çdo pikëpamje, ne bëhemi gjithmonë e më të mirë? Megjithatë, le të supozojmë se ju pranoni evoluimin e Kushtetutës. Çfarë prisni ju nga përdorimi i kësaj teorie? Unë mendoj, përmirësimin e standardeve të shoqërisë Amerikane. Pra, ju nuk prisni përmirësimin e standardeve të mirësjelljes së botës. Ju nuk prisni përmirësimin e standardeve të mirësjelljes së vendeve të tjera që nuk kanë kulturën tonë, pikëpamjet tona morale. Çfarë vlere të besueshme për standardet amerikane të mirësjelljes, do të kishte ligji i huaj? Sigurisht, ju mund të citoni ligjin e huaj për të treguar—Gjyqtari Breyer dha një shembull—se, nëse Gjykata e adopton këtë pikëpamje të caktuar të Kushtetutës, nuk do të bjerë qielli. Nëse do të mbajmë shumë më tepër

---

<sup>4</sup> Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara neni I x 8 cl. 3 (dhënia Kongresit të pushtetit për të rregulluar tregtinë ndërmjet shteteve, dhe e interpretuar se përfshirja e përdorimit të kanaleve tregtare ndërshtetërore, mjetet e kësaj tregtie dhe aktivitetet kanë një lidhje të rëndësishme me të).

qëndrim “latitudinarian” (tolerancë në doktrinat fetare) në lidhje me qasjen tonë mbi Dispozitën e Sistemit Fetar, për shembull, gjërat nuk do të shkojnë keq. sepse, edhe Franca, e cila është ndoshta më strikte në Evropë në lidhje me ndarjen e kishës nga shteti, e lejon shumë më tepër asistencën e shtetit për fenë. Për këtë është e dobishme.

Por, është krejt a pamundur që praktika franceze të jetë ndihmuese në përcaktimin e evoluimit të standardeve të mirësjelljes së shoqërisë amerikane. E vetmja mënyrë që ka kuptim për të përdorur ligjin e huaj është nëse ju keni një qasje të tretë për interpretimin e Kushtetutës, që do të thotë: “unë si gjyqtar nuk po kërkoj të gjej kuptimin origjinal të Kushtetutës, as edhe standardet aktuale të mirësjelljes së shoqërisë amerikane. Unë po kërkoj të gjej se cila është përgjigja më e mirë për çështjet sociale në gjykimin tim, si një person inteligjent. Për këtë qëllim unë marr parasysh pikëpamjet e gjyqtarëve të tjerë, në të gjithë botën.”

Më lejoni që t’ju pyes ju, studentëve të drejtësisë këtu. A mendoni se ju jeni përfaqësuesit e shoqërisë amerikane? A nuk e kuptoni se ju jeni një shtresë e vogël kremi në majën e sistemit shkollor dhe se pikëpamjet tuaja mbi një numër të madh gjërash, nuk janë pikëpamjet e Amerikës në tërësi? Përsëri ky është i vetmi kontekst në të cilin përdorimi i ligjit të huaj ka kuptim: kur ajo që ne jemi duke bërë nuk shikon historinë, siç bëj unë, as nuk sheh zakone të shoqërisë bashkëkohore amerikane, të cilën e kemi bërë për pak kohë. Në rastin Coker<sup>5</sup> për shembull, ne e quajtmë vendimin me vdekje për përdhunim, jo-kushtetues, sepse të gjitha shtetet, përveç njërit prej tyre, e kishin hequr këtë dënim për këtë lloj krimi. Në mënyrë realiste ju mund të thoni se standardet amerikane mbi këtë çështje kanë evoluuar. Por këtë e kemi hedhur pas krahëve. Në rastin tonë të fundit të Amendamentit të Tetë, 18 shtete nga 38 shtete që e kanë dënimin me vdekje, refuzuan që ta impononin atë mbi personat e sëmurë mendërisht. Shtetet e tjerë e lanë në dorë të jurisë për të vlerësuar nëse prapambetja e tij mendore mund të sillte zbutje të dënimit, duke marrë parasysh se sa i urryer ishte krimi i kryer. Megjithatë, ne thamë se ishin vetëm 18 prej 38, që mendonin ashtu, pra një minorancë. Por Amerika ka arritur tashmë një ndryshim në perceptimin e saj moral. Unë sugjeroj që deklarimi qëndron jo mbi perceptimet morale të Amerikës, por tek perceptimet morale të gjyqtarëve. sinqerisht, unë nuk dua ta marrë këtë përgjegjësi. Unë nuk dua ta bëjë këtë me ligjin e

---

<sup>5</sup> Coker kundër shtetit të Xhorxhia-s, 433 Shtetet e Bashkuara 584 (1977).

huaj dhe unë nuk dua ta bëjë këtë pa ligjin e huaj. Unë fle shumë mirë natën, sepse unë lexoj raste të ligjit të vjetër anglez. [Të qeshura.] Dhe kjo është përgjigjja ime.

**Breyer:** Kjo është një përgjigje e mirë. Me të vërtetë, unë mendoj se ju keni identifikuar diçka që në mënyrë të kuptueshme shqetëson shumë njerëz. Gjykatësit përpiqen që të mos marrin vendime në mënyrë subjektive për rastet. Ata e kuptojnë joshjen, në rastet e vështira me pyetje të hapura të ligjit kushtetues, për të krahasuar pikëpamjen e gjerë të publikut, ose pikëpamjen e ndonjë hartuesi, me pikëpamjen e tyre. Robert Braucher, një nga profesorët e mi të juridikut dhe më vonë një Gjyqtar i Gjykatës së Lartë të shtetit të Massachusetts e kishte për zakon të thoshte “Kur unë dua të di se çfarë mendon një njeri i thjeshtë, unë pyes veten se çfarë mendoj unë, dhe kështu kam të drejtë në çdo kohë.” [Të qeshura.] Gjyqtari në raste të tilla kërkon që të mos imponojë pikëpamjet e tija morale, po kërkon për një standard më objektiv.

**Scalia:** Ishte duke bërë shaka.

**Breyer:** Më lejo të theksoj një lëshim që ju keni bërë (ose duhet të kishit bërë). E mbani mend rastin që përfshinte një parim të rëndësishëm federalist, një rast që konsideronte që një ligj federal nuk mund të urdhërojë direkt një zyrtar shteti?

**Scalia:** Printz kundër United States.<sup>6</sup>

**Breyer:** Po. Duke mos u pajtuar, unë argumentova që sipas kësaj, qeveria federale i bie të ndërtojë një burokraci federale për të mbaruar punët; kur në fakt, një pikëpamje e kundërt do ta lejonte qeverinë federale të përdorë burokracinë ekzistuese shtetërore për të zbatuar ligjin federal. Unë theksova se në Bashkimin Evropian dhe në Zvicër qeveritë federale i përdorin burokracinë shtetërore.

**Scalia:** Cituat Zvicrën, apo jo?

**Breyer:** Po. Dhe unë thashë se Zvicra beson se një ligj që do të kërkonte ngritjen e një burokracie federale të panevojshme, do të promovonte pikërisht, të kundërtën e asaj që nënkupton federalizmi. Dua të theksoj se disa nga vërejtjet tuaja, të paktën janë në përputhje me faktin se referimi me Zvicrën është referimi i duhur. Shkaku pse ka një diskutim mbi ligjin e huaj ka të bëjë fare pak me citimin e Zvicrës për rastet e federalizmit, por ka të bëjë shumë me citimin e ligjit të huaj për rastet e dënimit me vdekje. Kështu do të sjell një shembull për këtë të fundit, ku, jo për ndonjë çudi, unë

---

<sup>6</sup> Printz kundër Shteteve të Bashkuara, 521 Shtetet e Bashkuara 898 (1997)



veprova kështu dhe besoj se veprova drejt. Asnjë gjë tek Blackstone, asgjë tek Bracton, asgjë edhe tek librat e ligjit të Mbreti Arthur, nuk thotë se një gjyqtar, kur vendos se çfarë përbën “dënimi mizor dhe i pazakontë,” duhet ta kufizojë shqyrtimin e tij vetëm tek Shtetet e Bashkuara apo tek Shtetet e Bashkuara plus Britaninë e Madhe. Të paktën asnjë nga ne nuk ka gjetur në këto libra një pengesë të tillë dhe unë parandiej se ti ke kërkuar për to.

Unë nuk u pajtova me mohimin e një peticioni për shqyrtimin e një rasti që ngrinte pyetjen: A është një “dënim mizor dhe i pazakontë,” kur qeveria e detyron një person të dënuar për vrasje të presë në radhën e dënimit me vdekje për më shumë se 20 vjet përpara ekzekutimit eventual? Duke iu referuar rasteve të tilla, unë përfshiva një vendim nga Privy Council në Angli (që rrëzonte një rast të Xhamajkës).

**Scalia:** Ata nuk u kushtojnë vëmendje as edhe opinioneve të tyre. [Të qeshura.]

**Breyer:** Unë iu referova një vendimi të Gjykatës së Lartë të Indisë dhe një rasti të Gjykatës së Lartë të Kanadasë. Iu referova disa përcaktimeve të Kombeve të Bashkuara, pra, ato që unë i mendova ndihmuese. Por unë nuk e kufizoj veten time vetëm tek vendimet që mbështesin pozicionin tim. Unë u referohem vendimeve që janë ndryshe, gjithashtu. Unë mund të kem bërë diçka që dikush mund ta quajë gabim taktik, kur iu referova një rasti nga Zimbabve, i cili nuk është kryeqyteti i botës për të drejtat e njeriut. Por ai rast, i shkruar nga një gjyqtar i mirë, Gjyqtari Gubbay, ishte interesant dhe i takonte një kohe të hershme. Unë nuk besoj se ndonjë nga këto vendime të huaja ka qenë i komanduar. Duke arritur tek këto vende të tjera, duke lexuar vendimet e tyre, duket se jam ndihmuar, megjithëse ato nuk mund të përcaktojnë rezultatin e çështjes që ngrihet sipas Kushtetutës Amerikane.

**Scalia:** Le të flasim për rastin ekzakt që ti solle—

**Breyer:** Unë solla një rast që ilustroi vështirësitë e qasjes sime.

**Scalia:** Ai rast paraqiti pretendimin se ishte dënim mizor dhe i pazakontë të pritej shumë ndërmjet momentit të shpalljes së dënimit me vdekje dhe ekzekutimit. Ne nuk kemi vendosur akoma mbi këtë çështje; thjesht e kemi rrëzuar që ta marrim në shqyrtim.

**Breyer:** Po.

**Scalia:** Një nga vështirësitë e përdorimit të ligjit të huaj është se ju nuk e kuptoni, cila është jurisprudenca që e rrethon atë. Për shembull, ju mund të thoni, “Rusia zbaton ligjin Miranda”, por ju nuk dini se Rusia mund të ketë një rregull përjashtues.

Ju mund të thoni se çdo vend tjetër i botës mendon se ta mbash dikë për dymbëdhjetë vjet nën dënimin me vdekje është mizore dhe e pazakontë. Por ju nuk e dini se këto vende nuk kanë sisteme “*habeas corpus*” që të lejojnë të përsëritësh ankimin ndaj gjyqit shtetëror, apo federal, kështu që, arsyeja që këtu shkon 12 vjet është, sepse i dënuari si vrasës vazhdon vetë të apelojë edhe pse këto apeline hidhen poshtë vazhdimisht.

Në Angli, përpara se ta hiqnin dënimin me vdekje—dhe meqë ra fjala, çdo sondazh publik në Angli sugjeron që njerëzit do të donin ta mbanin dënimin me vdekje,—pra, përpara se ata ta hiqnin dënimin me vdekje, gjyqtari që e shpallte atë duhet të vishte një kapuç. Kur ju e shihnit atë të vinte me një kapuç, ju e dinit se ai do të shpallte një dënim me vdekje. Dhe ky dënim do të ekzekutohej brenda dy javësh. Prandaj ky është edhe shkaku që 12 vjet duken të pazakonta. Por mbi të gjitha, çfarë e bën opinionin e një gjyqtari të urtë nga Zimbabve, apo të një anëtari të urtë të Komitetit të Ligjeve të Dhomës së Lordëve, të ketë të bëjë me atë se çfarë besojnë amerikanët?

**Breyer:** Mirë, ka lidhje në sensin që unë përshkrova. Një gjyqtar, me një trajnim të ngjashëm, përpiqet të aplikojë një dokument në të njëjtën gjuhë (“dënim mizor dhe i pazakontë” ose diçka e ngjashme), në një shoqëri që është disi e ngjashme demokratike dhe mbrojtëse e të drejtave bazë të njeriut. Anglia nuk është hëna, as India nuk është. Në fakt, në mënyrë ironike në ato fusha ligjore më specifike—fusha ku rezultatet janë më shumë të lidhura me detajet e një ambienti të ndryshëm ligjor—referencat tek vendimet e huaja kanë gjasa të rezultojnë më pak kundërshtuese.

**Scalia:** A keni ndonjë pyetje tjetër?

**Dorsen:** Po. Dua t’i bëj secilit gjyqtar nga një pyetje. Do t’i hedh të dyja pyetjet mbi tavolinë. Për gjyqtarin Scalia do ta formuloja kështu. Megjithëse ju keni sugjeruar një pikëpamje, unë përsëri jam i paqartë rreth asaj se cili është dëmi apo risku i marrjes në konsideratë të burimeve të huaja. Për shembull, të dy ju keni përmendur dënimin me vdekje. Pse vendimet kushtetuese të Shteteve të Bashkuara nuk duhet të marrin parasysh ndryshimin e standardeve botërore mbi çështje të tilla si dënimi me vdekje, ekzekutimi i

të rinjve, ekzekutimi i të sëmurëve mendorë? A jemi ne kaq larg nga pjesa tjetër e botës nga pikëpamja e mënyrës se si jetohet jeta?

Pyetja për Gjyqtarin Breyer është një variant i diçkaje që Gjyqtari Scalia tha në komentet e tij të hapjes. A është e drejtë t'ju kritikojmë ju dhe anëtarët e tjerë të Gjykatës së Lartë, që u referohen burimeve të huaja, edhe pse nuk i konsideroni ato si detyruese? Unë nuk jam i sigurt, por nuk shoh aq shumë citime të gjyqeve të Azisë Lindore, të gjyqeve të Amerikës Jugore, të gjyqeve Islamike. A është kjo një kritikë e drejtë se ka një farë seleksionimi që orientohet nga rezultati në mënyrën se si merren në konsideratë referencat e huaja nga ju?

**Breyer:** Po, është një kritikë e drejtë. Ne u jemi referuar opinioneve të Gjykatës së Lartë të Indisë. Por unë e pranoj se nga vendet e tjera aziatike vijnë më pak opinione në vëmendjen tonë. Ky është njeri nga shkaqet pse është e rëndësishme që ne të kuptojmë se, vendimet e gjykatave të huaja nuk janë detyruese. Unë do të dëshiroja të kemi rregullin e përgjithshëm “merre për atë që ia vlen”, në vend që të përpiqeshim të zhvillonim një jurisprudencë, mbi atë se në ç ‘raste gjyqtarët amerikanë duhet apo nuk duhet, të marrin në konsideratë një vendim të huaj. Do ta evitoja tendencën natyrale të mendjes ligjore, tendencën që fillimisht, bën dallimet dhe pastaj krijon rregullat. Vendimet e huaja nga kjo pikëpamje janë pak si histori legjislative. Po kështu edhe kritika për përdorimin e tyre është e njëjtë.

**Scalia:** Sigurisht që është.

**Breyer:** Kritika mund ta shpreh idenë në mënyrë të përmbledhur tek komenti i gjyqtarit

**Harold Leventhal:** Të përdorësh historinë legjislative është si të shikosh mbi turmën tek një mbrëmje kokteji për t’u përpjekur që të identifikosh shokët e tu. [të qeshura.]

**Dorsen:** Gjyqtari Scalia?

**Scalia:** Ky nuk mund të jetë i vetmi shpjegim për të mos përdorur burime të tjera të huaja, sepse ne nuk e dimë se çfarë thonë vendet e tjera. Tek mospajtimi im në rastin e Lawrence, rasti i marrëdhënieve homoseksuale, unë vura re se gjykata citoi vetëm ligjin Evropian, sipas të cilit nuk mund t’i ndaloni marrëdhëniet homoseksuale.

Sigurisht, ata e kanë thënë këtë, por jo si një pasojë e ndonjë votimi demokratik, por me vendim të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që ka përdorur të njëjtën teori sipas të cilës ne juristët, gjyqtarët dhe studentët e ligjit e dimë se çfarë është morale dhe se çfarë nuk është. Megjithatë, është e vërtetë që në të gjithë Evropën është e paligjshme të ndalohen marrëdhëniet homoseksuale. Gjykata nuk citoi pjesën tjetër të botës. Është e thjeshtë ta zbulosh se çfarë thotë pjesa tjetër e botës rreth kësaj. Unë e kam cituar tek opinionimi im mospajtues. Pjesa tjetër e botës është e ndarë në mënyrë të barabartë.

**Breyer:** Arsyeja që shumica iu referua rasteve të huaja tek rasti Lawrence është që Gjykata, në vendimin e saj më të hershëm të Bowers kundër Hardwick<sup>7</sup>, kishte thënë se marrëdhëniet homoseksuale janë të ndaluara gati në mënyrë universale. Unë mendoj se Lawrence përmes referencave të tij thjesht donte të tregonte që kjo ishte e gabuar.

**Scalia:** Në rregull, e kuptoj. Por mos fol vetëm për Evropën. Le të shohim pjesën tjetër të botës.

**Breyer:** Shiko, më lejo...—

**Scalia:** Unë kam një vendim nga një njeri inteligjent në Zimbabve, apo kudo tjetër dhe pastaj ti e merr atë dhe e citon. Për zotin, duket juridike! [të qeshura.] Dhe të çon vet tek manipulimi. Thjesht të çon atje!

**Breyer:** Unë do të dëshiroja të përmendja një çështje tjetër, e cila shqetëson shumë persona në këtë audiencë dhe në Fakultetet Juridike. Çështja e “Ligjit të huaj” që unë besoj se del në shumë raste më pak të bujshme. Tre nga rastet e vitit të kaluar kishin lidhje me terrorizmin. Këto raste kishin ndërlikime me ligjin e huaj, por ishin raste shumë të veçanta dhe unë po i lë mënjanë. Kishim pastaj një rast që përfshinte Konventën e Varshavës. Dhe ju shkruat për Gjykatën një opinion shumë të mirë.

**Scalia:** Ti, Stephen, shpesh u bashkohesh opinioneve të mija. [Të qeshura.]

**Breyer:** Sigurisht që po.

**Scalia:** Por vetëm atyre që janë të mira, apo jo? [Qesh vet, si dhe të qeshura.]

**Breyer:** Pse nuk janë të gjitha të mira? [Të qeshura.]

**Breyer:** Argumenti im është që në rastin e Konventës së Varshavës, ti pe se si gjykata të tjera, në vende të tjera, kanë aplikuar tekstin e kësaj Konvente. Po kështu, kemi

---

<sup>7</sup> Bowers kundër Hardwick, 478 Shtetet e Bashkuara 186 (1986)

patur një rast interesant që përfshinte aplikimin e ligjeve amerikane antitrust, në të cilin një shpërndarës i vitaminave në Ekuador kishte paditur një prodhues holandez të vitaminave, duke kërkuar zhdëmtim për fiksime të çmimeve ku ishin të përfshira firma Amerikane dhe Evropiane. ndërkohë, në pjesën më të madhe veprimtaria kryhej jashtë SHBA-së. Një viktimitë e karteleve që fiksonin çmimet, a mund t'i kërkonte një gjykatë Amerikane të dëmshpërblehej me trefishin e dëmeve? Ne shqyrtoam një rast në të cilin kamionistët amerikanë kundërshtonin hyrjen në SHBA të kamionistëve meksikanë që donin të transportonin mallra përmes kufirit, sepse NAFTA, (Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Amerikës së Veriut)<sup>8</sup> thoshte që ata mundeshin. Megjithatë, a mund një kërkesë që paraqiste impakt në mjedis, t'i mbante këta kamionistë jashtë? Ne kemi shqyrtuar përpjekjet ligjore të një trashëgimtareje që kishte ngritur padi për të marrë nga muzeu i Vjenës 5 piktura të Klimt, të cilat i ishin sekuestruar familjes së saj nga nazistët në Luftën e Dytë Botërore.

**Scalia:** Rast i mrekullueshëm.

**Breyer:** Dakord. Këto raste që janë më shumë raste teknike, janë ngritur si “*amicus briefs*” (nga palë që nuk përfshihen direkt, por me interes të madh publik) nga shumë qeveri dhe institucione të huaja. Në rastet antitrust, për shembull, ndërhyrjet janë ngritur nga Qeveria e Gjermanisë, nga Bashkimi Evropian dhe të tjerë. Këto raste nuk ishin deklarata të përcipta për të shprehur një pozicion, por ndërhyrje me një përmbajtje të lartë për ta ekzaminuar ligjin në themel.

Kjo është bota sot. Është një botë në të cilën fakultetet e drejtësisë nuk mund ti kufizojnë ato të cilat u mësojnë studentëve mbi ligjin e huaj, vetëm tek një kurs i quajtur “ligji i huaj.” Biznesi është ndërkombëtar; kështu që edhe ligji që ndikon tek biznesi është ndërkombëtar. Të Drejtat e Njeriut, gjithashtu, janë bërë një çështje më shumë ndërkombëtare. Këto fakte rreth botës thonë se juristët dhe gjyqtarët duhet të dinë më shumë mbi botën. Ata nuk mund të dinë gjithçka. Ata nuk mund të mësojnë ligjet e çdo vendi. Juristët nuk dinë as edhe ligjet e një vendi. Më mirë ata mësojnë se ku mund t'i gjejnë ligjet. Të njëjtën gjë mund të bëjnë edhe për ligjin e huaj..

**Dorsen:** Do të doja t'ju pyesja edhe një pyetje të fundit dhe ju jeni, sigurisht, i lirë që ose ta evitoni ose t'i përgjigjeni asaj.

---

<sup>8</sup> North American Free Trade Agreement (Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Amerikës së Veriut)

**Scalia:** Unë nuk ju përgjigja pyetjes suaj të mëparshme. Madje, e harrova fare se cila ishte pyetja.[Të qeshura.]

**Dorsen:** Le ta lëmë pas krahëve.

**Scalia:** Dakord. [Të qeshura.]

**Dorsen:** Në frymën e miqësisë.

Pyetja që unë kam është: Më mirë se sa të shohim gjyqet e huaja, për të thënë për shembull se Greqia vendosi në këtë mënyrë, Mbretëria e Bashkuar ka vendosur sipas mënyrës sonë, vendi X ka vendosur në një mënyrë tjetër, më mirë se sa të mendojmë rreth këtyre gjyqeve dhe këtyre rasteve nga pikëpamja e rezultateve, le të mendojmë për to nga pikëpamja e forcës bindëse të opinioneve. P.sh. një gjykatë e New York-ut mund të marrë në konsideratë një vendim të shtetit Montana dhe të influenohet jo nga rezultati i gjykatës së shtetit Montana, por nga forca bindëse e argumenteve, nga thellësia e arsyetimit, nga logjika. Nëse gjykatat tona marrin në konsideratë gjykatat e një vendi tjetër dhe janë në gjendje që të gjejnë opinione bindëse, pse të mos jetë kjo, një rrugë e informimit të gjyqtarëve tanë në një mënyrë pozitive?

**Scalia:** Mirë, ju po e ngrini me lutje pyetjen. Dua të them, pyetja juaj supozon se varet nga gjyqtari që të gjejë përgjigjen korrekte. Unë nuk e pranoj që varet nga gjyqtari për të thënë se çfarë na jep Kushtetuta, edhe për të na thënë se ajo që jepet nuk është përgjigja më e mirë, edhe nëse ju mendoni se kjo duhet amenduar. Kushtetuta duhet përditësuar. Por duhet përditësuar me pikëpamjet e popullit amerikan. Ju mund të keni argumente të ndryshme, por ajo që duhet të pyesni veten është se çfarë mendon për këtë shoqëria amerikane? Dhe mënyra më e mirë, mënyra e vetme për ta përcaktuar këtë është sigurisht, të mos pyesësh vetëm një segment të hollë të shoqërisë amerikane gjyqtarët, juristët dhe studentët e drejtësisë, se çfarë mendojnë ata, por të merret parasysh legjislacioni që ekziston tek shtetet, i adoptuar në mënyrë demokratike nga populli Amerikan.

Unë jam i sigurt që burra dhe gra inteligjentë jashtë, mund të japin argumente shumë inteligjente, por nuk është kjo çështja, sepse nuk varet nga unë për të bërë këto përcaktime morale.

**Dorsen:** Gjyqtari Breyer, dëshironi të komentoni mbi këtë?

**Breyer:** Po. Të marrim në konsideratë rastin e znj. Bowman. Znj. Bowman, besoj unë, favorizon të drejtën e jetës. Ajo është një qytetare e Britanisë së Madhe. Ajo kishte dëshirë që të kontribuonte me një shumë të vogël parash për të printuar literaturë që do të identifikonte kandidatët “pro-jetës” (ose pro-zgjedhjes). Ligji britanik nuk e lejon kryerjen e këtij kontributi kaq afër me datën e zgjedhjeve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e shqyrtoi ankesën dhe vendosi se ligji britanik ka shkelur lirinë e shprehjes të garantuar nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut<sup>9</sup>. A nuk tingëllon e njohur kjo çështje? Një argument në favor të znj. Bowman ishte se, ishte e paarsyeshme që ta ndaloje kontributin e saj, ndërkohë që gazetat lejohen të flasin për gjëra të njëjta kurdoherë që ato dëshirojnë. A nuk tingëllon ky argument i njohur? Pse është e paarsyeshme për mua që të jem kurioz në lidhje me faktin se, si Gjykata Evropiane i ka trajtuar këto argumente. Unë nuk jam i detyruar nga ato që janë thënë në gjyq. Por pse unë nuk mund ta shoh atë?

**Scalia:** Shiko, Unë nuk të ndaloj ty që t’i lexosh këto raste.

**Breyer:** Në rregull, a nuk është kjo ekzaktësisht [Të qeshura.]—

**Scalia:** Dua të them, vazhdo dhe kënaqe kuriozitetin! Thjesht mos i vër në opinionin tënd! [Të qeshura.]

**Breyer:** Pikërisht aty ku e filluam. [Të qeshura.]

**Dorsen:** Do të doja tani të kalonim tek koha e pyetjeve. Gjyqtarët me mirësjellje kanë pranuar t’u përgjigjen pyetjeve. Kenneth Anderson, një profesor i Universitetit Amerikan, i Fakultetit të Drejtësisë Washington, do tu drejtohet njerëzve që kanë pyetje.

**Anderson:** Ju faleminderit. E fillojmë me Profesor Michel Rosenfeld, president i Shoqatës të Ligjit Kushtetues të SHBA, shoqatë e cila është edhe bashkë-sponsor i këtij aktiviteti.

**Rosenfeld:** do të dëshiroja që t’i drejtoja nga një pyetje secilit gjyqtar. Duke dëgjuar Gjyqtarin Scalia, unë kam një ndjenjë se përveç çështjes së ndjenjave të popullit Amerikan, pozicioni i tij ka shumë pak të bëjë me materialet e huaja. Në parim, si një origjinalist (në interpretimin e Kushtetutës), Gjyqtari Scalia dëshiron të dijë se çfarë nënkuptonte Kushtetuta kur ajo u adoptua, dhe çdo gjë tjetër, përveç atyre që nuk do të kishin lidhje me të.

---

<sup>9</sup> Bowman kundër Mbretërisë së Bashkuar, shënimi i mësipërm Nr.4

Nëse historianët e kanë gjetur në mënyrë bindëse se hartuesit kishin për qëllim të përfshinin, ose ishin të frymëzuar shumë nga ligji francez ose hollandez i shekullit të shtatëmbëdhjetë ose tetëmbëdhjetë, po Gjyqtari Scalia, sigurisht si origjinalist, a do ta shikonte këtë burim të huaj? E njëjta gjë me çështjet e moralit, përveç atyre çështjeve që duhet konsultimi i ndjenjave të popullit Amerikan. Mua më duket se ka liberalë të cilët kanë pikëpamje të caktuara morale, si dhe ka të tjerë që kanë pikëpamje të ndryshme morale, dhe Gjyqtari Scalia hedh poshtë, të paktën me aq sa mund ta them unë, pikëpamjet liberale mbi çështjet X, Y ose Z, si çështje jo të përshtatshme kushtetuese, pavarësisht nëse çështja është Amerikane apo e huaj. Kështu që, pyetja ime për Gjyqtarin Scalia është kjo: supozoni se gjykata juaj nuk ka pasur kurrë ndonjë jurisprudencë mbi abortin, dhe e gjithë jurisprudenca për abortin është e gjyqtarëve kanadezë. A do të kishte ndonjë interes, ose a do të kishte ndonjë pikë lidhje me mënyrën se si është arsyetuar (është arsyetuar mirë, apo jo mirë, a është e dobishme ose nuk është e dobishme) për zhvillimin e doktrinës?

Tani pyetja ime për Gjyqtarin Breyer. Ju përmendët shembullin e francezëve që e lejojnë shtetin që të subvencionojë shkollat fetare. Unë e di se ju jeni shumë i njohur me situatën në Francë. Por ndonjë gjykatës tjetër mund të mos jetë aq i njohur me 'të. Në Francë, ka shumë më pak frymë fetare se sa në Shtetet e Bashkuara. Populli francez duket që është shumë më pak fetar dhe institucionet e shtetit janë shpesh antifetare. Prandaj, ndonjë mund të kundërshtojë duke thënë se, nuk është i njëjti perceptim për rrezikun që ka kur qeveria kujdeset për fenë në Francë, se sa në Shtetet e Bashkuara. Pyetja është: a nuk është problem përdorimi e materialeve të huaja, sepse një qenie njerëzore që është gjykatës në një vend, në asnjë mënyrë, nuk mund të ketë informacion të plotë e të mjaftueshëm në lidhje me një vend tjetër për të përfshirë apo për të cituar jurisprudencën e atij shteti tjetër?

**Scalia:** Në rregull. Po ju e mbani mend pyetjen time? [Të qeshura.] . . . Unë nuk do ta merrja në konsideratë ligjin kanadez. Në lidhje me çështjen e abortit, si një origjinalist, unë do të shqyrtoja tekstin e Kushtetutës, e cila nuk thotë asgjë për këtë temë në ndonjë mënyrë apo në ndonjë tjetër. Ju e dini, të dyja palët do të donin që unë të thosha se, Kushtetuta kërkon që shtetet ta lejojnë abortin, ose Kushtetuta kërkon që shtetet ta ndalojnë atë. Unë shqyrtoj tekstin. Teksti i Kushtetutës nuk thotë asgjë për të.



Unë shikoj tek 200 vjetët e historisë. Asnjë nuk ka menduar ndonjëherë se Kushtetuta ka thënë ndonjë gjë për këtë çështje.

Unë e konsideroj Kushtetutën sikur ka vendosur një dysHEME të asaj që, mund të bëhet në mënyrë demokratike. Nuk është puna që Kushtetuta të ndërrohet me vendim gjyqësor; ndryshimi vjen nga legjislacioni demokratik. Aborti është i ndaluar. Ju doni ta ndryshoni këtë? Në rregull. Të bindim njeri-tjetrin për këtë dhe të eliminojmë ligjet kundër abortit.

Unë nuk kam ndonjë problem me ndryshimin. Thjesht unë nuk e konsideroj Kushtetutën sikur të jetë instrumenti i ndryshimit duke i lejuar gjyqtarët të lexojnë rastet kanadeze dhe të thonë, “Po, do të ishte një ide e mirë që të mos kishte ndonjë kufizim për abortin.” Kjo nuk është mënyra se si ne i bëjmë gjërat në një demokraci. Bindini bashkëqytetarët tuaj dhe shfuqizojini ligjet. Pse duhet ta vendosë Gjykata e Lartë këtë çështje?

**Breyer:** Pyetësorët pa dyshim, të pyesin si e kalon ditën e punës. Dita ime e punës lidhet me leximin dhe të shkruarin. Unë punoj tek një kompjuter. Vite të shkuara i thashë djalit tim që nëse ai i bënte detyrat e tij të shtëpisë mirë, si përfundim ai do të gjente një punë ku do të bënte detyra shtëpie gjithë jetën. [Të qeshura.] Çfarë lexoj unë? Ndryshe nga përshtypjet e disave, unë nuk lexoj edicionet e Colbert-it. Unë lexoj përmbledhje rastesh. Këto përmbledhje rastesh shpjegojnë ligje me të cilat shpesh nuk kam qenë i njohur më parë, për shembull ligji i pronës në shtetin e Luiziana-s, që është shumë i përshtatshëm për interpretimin e një dispozite të ERISA<sup>10</sup>, të cilën Shoqata e Avokatëve të shtetit të Kalifornisë e ka shpjeguar shumë bukur në një përmbledhje rasti.

Këto përmbledhje rastesh duhet të shpjegojnë ligjin e huaj gjithashtu. Kjo sepse ligji i huaj vjen para nesh më shpesh, nëpërmjet rasteve të zbulimeve. Juristët duhet ta shpjegojnë atë, duke ndarë informacionin më të rëndësishëm nga informacioni më pak i rëndësishëm. Nëse ka çështje të ligjit të huaj që janë të rëndësishme, interesante dhe të përshtatshme, juristët duhet t'i nxjerrin ato në pah. Nuk dua të them se unë jam atje që të nxis të keqen. [Të qeshura.] Unë jam atje që të ndjek ligjin. Kjo është ajo se çfarë ne të gjithë mendojmë.

---

<sup>10</sup> Akti për Sigurimin e të Ardhurave të Pensionit të Punonjësit, 29 U.S.C. (1974).

Për më tepër, secili nga ne aplikon një strukturë që mund të përshkruhet në mënyrë të ngjashme me terma të përgjithshëm. Ne shohim tekstin e dokumentit. Ne marrim në konsideratë historinë. Ne marrim në konsideratë traditën. Ne marrim në konsideratë rastet e mëparshme. Ne kërkojmë vlerën ose qëllimin që nënvizon teksti ligjor dhe duam të dimë pasojat e vendimit tonë, pasojat e para përmes prizmit të vlerave, ose të qëllimit që nënvizon teksti. Por, jo domosdoshmërisht ne i japim të njëjtën peshë secilit prej këtyre faktorëve. Disa nga ne, me kalimin e kohës, tentojnë të vendosin një rëndësi më të madhe mbi disa faktorë, sesa mbi disa të tjerë. Ndryshimet janë ndryshime të theksimit. Është e rëndësishme të mos e teprojmë me to. Nga pikëpamja juaj si një student i drejtësisë, ose edhe si profesor, ose si gjyqtar, ose si praktikues i të drejtës, ngjashmëritë janë më të rëndësishme se sa ndryshimet.

**Anderson:** Fjala është e hapur për ju<sup>11</sup>.

**Pyetje:** Neni VI i Kushtetutës të Shteteve të Bashkuara thotë që, Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në bazë të saj, janë ligji suprem mbi tokë dhe gjyqtarët e gjykatat në çdo shtet, janë të detyruara prej saj. Kur ju Gjyqtari Breyer, bëtë betimin, dhe kur Presidenti të bëjë betimin, betimi nuk është të mbrosh Shtetet e Bashkuara, betimi është që të mbrosh Kushtetutën. Kushtetuta nuk thotë, as edhe betimi nuk e thotë, që do të mbrojmë Kushtetutën siç është interpretuar nga një gjyqtar në Zimbabve, ose në Xhamaika, apo në Indi. Unë jam shumë kurioz të di se, si justifikohet kjo. Ju faleminderit!

**Breyer:** Unë besoj se jam duke interpretuar Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Nëse, për shembull, një gjyq i huaj, në një vendim të veçantë, ka treguar se një interpretim i posaçëm i të njëjtës gjuhë, në një dokument të njëjtë, ka patur një efekt të pafavorshëm mbi lirinë e shprehjes, duke e lexuar këtë vendim mund të më ndihmojë mua për të zbatuar Kushtetutën Amerikane. Kjo, është. Siç e kam thënë, në botën e sotme ku eksperiencia të ngjashme, të përshtatshme, bëhen gjithmonë e më shumë të përbashkëta, kamë shumë të ngjarë që ne të mësojmë nga vendet e tjera. Unë dyshoj se Franklin, ose Hamilton, ose Jefferson, ose Madison, madje, edhe George Washington-i, do ta kishin menduar se ne nuk mund të mësojmë ndonjë gjë me vlerë nga jashtë.

**Scalia:** Mund t'i përgjigjem unë kësaj?

---

<sup>11</sup> Shënim i redaktorit: Për arsyen se jo të gjithë ata që drejtuan pyetje janë të njohur; ne nuk kemi bërë identifikimin e tyre në mënyrë selective.

**Anderson:** Po, ju lutem.

**Scalia:** Ju e dini, është një Kushtetutë që përmban fraza të parimeve të përgjithshme të tilla si “proces i drejtë ligjor”. Nëse do të ndiqnit qasjen e një origjinalisti, pyetja është: çfarë besonin hartuesit mbi një proces i drejtë ligjor? Për shkak të teorisë sime për Kushtetutën, ky ishte proces i drejtë ligjor dhe përsëri, ky është edhe sot, përveçse kur ju amendoni Kushtetutën. Ndërsa, nëse ju besoni “proces i drejtë ligjor” është një ftesë për gjyqtarët, juristët dhe studentët e drejtësisë inteligjentë që të imagjinojnë se çfarë konsiderojnë ata të jetë “proces i drejtë ligjor”, si dhe të konsultohen me gjykatësit e huaj, me të vërtetë që ju nuk do ta dinit se çfarë të thotë betimi, se do të mbështesni dhe mbronni Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara. Ndryshon formë. Ndryshon!

**Pyetje:** Pyes veten se sa serioz jemi ne, në lidhje me moslejimin që, qytetarët e ShBA të bëhen subjekt të arsyetimeve kushtetuese të gjykatave të huaja. Unë mendoj se kjo do të bëhet një çështje e madhe me paditë për shpifje në Internet, të cilat tani janë duke bërë bujë dhe kanë sjellë ndërlikime shqetësuese për Amendamentin e Parë. Disa amerikanë që janë vënë në lojë nga gazeta apo revista të SHBA, janë gjykuar jashtë shtetit në një gjykatë të huaj, e cila merr vendimin se ndaj tyre është shpifur, diçka që nuk do të ndodhte kurrë nën Amendamentin tonë të Parë. Nuk mund të bëhet asgjë për të ndaluar gjykatat e huaja që të pretendojnë juridiksionin e tyre mbi amerikanët, thjesht sepse materiali i shkruar është online. Por a duhet që gjykatat amerikane të bashkëpunojnë me këto politika mendjengushta duke zbatuar gjykimet e huaja kundër amerikanëve për lirinë e shprehjes?

**Scalia:** Është realisht një problem i madh. Ne akoma nuk jemi ballafaquar me ndonjë rast që e përfshin këtë problem, por kur të na vijë një rast i tillë do të... me të vërtetë do të...

**Breyer:** Ne do të tregojmë seriozitet. [Të qeshura.]

**Scalia:** Dëgjo, gjëja që ti e di tani me siguri është se ne do ta zgjidhim siç duhet. [Të qeshura.]

**Pyetje:** Jam pak në siklet, sepse komentet e mija nuk janë në formën e një pyetje. Unë mendoj se thelbi i çështjes është me të vërtetë funksioni i gjyqtarit. Gjyqtari Scalia e ka thënë këtë shumë herë. Pyetja është, cili është roli i gjyqtarit? Ka një mosmarrëveshje

shumë të mprehtë këtu. Në kundërshtim me pikëpamjen e gjyqtarit Scalia, unë do të sugjeroja, që qëllimi i teorisë origjinaliste të ishte synimi për të qenë inovativ. Rasti Weems<sup>12</sup>, që ka nocione të evoluimit të standardeve, daton që në vitin 1908. U riafirmua përsëri në vitet tridhjetë dhe nocioni i qëllimit origjinal u zhvillua me të vërtetë në vitet shtatëdhjetë. Është fakt se unë nuk gjej shumë lidhje me qëllimin origjinal, deri sa arrijmë tek rasti Dred Scott<sup>13</sup>, i cili është një vendim i bazuar në qëllimin origjinal, ashtu siç është në një masë të gjerë, rasti Bradwell<sup>14</sup>, i cili thoshte se shteti i Illinois mund t'i përjashtonte gratë nga avokatia.

Meqë ra fjala, Aleksander Hamilton tha se ne duhet të tregojmë vëmendje tek gjykimet e vendeve të tjera. Kur Madison ishte duke u përgatitur për Konventën Kushtetuese, ai lexoi çdo gjë që mund të gjente në lidhje me qeveritë e tjera. Kjo nuk do të thotë se kur ne i lexojmë këto na duhet që edhe t'i marrim e t'i pranojmë ato, por ne duhet të përpiqemi t'i mësojmë ato. Të gjitha këto varen nga funksioni i gjyqtarit.

**Scalia:** Më lejoni që t'i përgjigjem kësaj pyetjeje. Aleksandër Hamilton, zotëri, ishte duke shkruar Kushtetutën dhe jo duke e interpretuar atë.

**Breyer:** Dakord.

**Scalia:** Dhe kur shkruani një të tillë, sigurisht ju konsultoheni me burimet e huaja, shikoni se si kanë funksionuar ato, shikoni se çfarë kanë bërë ata, përdor shembujt e tyre e kështu me radhë. Por kjo nuk ka të bëjë aspak, me interpretimin e saj. Përsa i përket evoluimit të standardeve të njerëzimit, kjo nuk vjen nga viti 1908, por vjen nga një rast i viteve pesëdhjetë që përfshin...

**Breyer:** Trop kundër Dulles<sup>15</sup>?

**Scalia:** Po. Trop kundër Dulles. Ajo që duhet të bëni është që të lexoni komentet e Joseph Story për të kuptuar se cili ka qenë interpretimi origjinal i Kushtetutës. Është e pandryshueshme, është si një shkëmb në të cilën ankorohen format e qeverisjes. Për sa i

---

<sup>12</sup> Weems kundër Shteteve të Bashkuara, 217 Shtetet e Bashkuara 349 (1910) (ndëshkimi i tepruar, duke përfshirë edhe punën e rendë që shkakton lëndim, shkel dispozitën e Kushtetutës “dënimi mizor dhe i pazakontë”).

<sup>13</sup> Dred Scott kundër Sanford, 60 Shtetet e Bashkuara. 393 (1856) (As skllavërit dhe as zezakët e liruar nga skllavëria nuk mund të bëhen ndonjëherë qytetarë të Shteteve të Bashkuara; e hedhur poshtë nga Amendamentet Trembëdhjetë e Katërbëdhjetë të Kushtetutës).

<sup>14</sup> Bradwell kundër Shtetit të Illinois, 83 Shtetet e Bashkuara 130 (1872).

<sup>15</sup> Trop kundër Dulles, 356 Shtetet e Bashkuara 86 (1958) (qeveria nuk mund t'ja heq një personi shtetësinë e Shteteve të Bashkuara si denim për një krim).

përket Dred Scott, i cili ishte rasti i parë origjinalist, ju e dinit se çfarë ishte Dred Scott apo jo? Dred Scott ishte rasti i parë që përdori teorinë e “procesit të drejtë të pavarur,” i cili ka qenë burimi i të gjitha inovacioneve të Gjykatës së Lartë në zhvillimin e standardit evolues të njerëzimit. Kështu që, kjo është përgjigja e pyetjes.

**Breyer:** Unë bie dakord me Gjyqtarin Scalia në lidhje me rolin e duhur të një gjyqtari. Por...

**Scalia:** Ne jemi duke diskutuar rreth një kategorie të ngushtë të rasteve, Stephen, dhe unë bie dakord.

**Breyer:** Nuk është vetëm kjo. Mosmarrëveshja jonë shpesh ka lidhje, jo vetëm me rolin e gjyqtarit, i cili është, sigurisht, për të zbatuar ligjin, por me rëndësinë e rregullave të qarta. Disa besojnë që, sa më pak rregulla dhe sa më pak qasje të qarta, aq më shumë pushtet për gjyqtarët. Nëse një normë ligjore, ose një praktikë vendimmarrëse lihet me një fund të hapur, mund të lejojë gjyqtarët që të zëvendësojnë pikëpamjet e tyre subjektive me ato të një organi ligjvënës. Ky zëvendësim është në kundërshtim me parimet e demokracisë. Unë e njoh problemin. Megjithatë, një normë ligjore, ose një praktikë vendimmarrëse, që nuk është fare me fund të hapur mund të prodhojë një kurë, e cila është më e keqe se sëmundja. Normat ligjore që janë jo-fleksibël, të cilat nuk përshtaten në mënyrë adekuate me rrethanat që ndryshojnë, prodhojnë ligje të ndarë nga jeta. Askush nuk do që ta ndajë ligjin nga jeta, si dhe askush nuk do gjyqtarë të pazgjedhur të cilët në mënyrë rutinë zëvendësojnë pikëpamjet e tyre subjektive me ato të zyrtarëve të zgjedhur. Diskutimi i çështjes mund të ndihmojë në gjetjen e përgjigjeve më të mira. Prandaj, kjo është një nga arsyet se pse unë e vlerësoj shansin e sotëm për diskutim.

**Pyetje:** Fillimisht për ju, Gjyqtari Breyer. Gjyqtari Scalia iu përgjigj një pyetjeje duke thënë, vazhdoni, lexojini të gjitha këto gjëra sa më shumë të keni mundësi, por pse duhet t’i vendosni ato në opinionet tuaja. Unë do të isha i interesuar që të dëgjoja nga ju një përgjigje për këtë, sepse mendoj se, të gjitha argumentet janë shumë të fortë nga pikëpamja e dobishmërisë për t’i lexuar këto materiale, por ato nuk përkthehen domosdoshmërisht në opinione.

Pak më gjatë për Gjyqtarin Scalia. Pse ligji Anglez, ligji Britanik, merr një trajtim të veçantë në analizat tuaja për mënyrën se si ne duhet ta trajtojmë ligjin e huaj? Unë e

bëj këtë pyetje, pasi e marr me mend se ka një sërë arsyesh që historia jonë dhe lidhja si një ish-koloni Britanike, mund edhe ta justifikojë. Por ne luftuam një luftë për shtatë vjet për të çliruar veten tonë nga ajo qeveri për shumë arsye, disa prej të cilave janë shumë thelbësore. Dakord, ne kemi më shumë lidhje sociale dhe kulturore me Anglinë por ne gjithashtu, kemi një lidhje sociale e kulturore me gati çdo vend tjetër në botë, duke pasur parasysh edhe natyrën e migracionit tonë.

Kështu, për shembull, në një çështje të tillë se si duhet të trajtojmë qeveritë e shteteve në lidhje me paditë kundër tyre, duke kërkuar një lloj përgjegjësie civile nga ana e qeverisë si institucion; në një rast të tillë, pse duhet të shohim mënyrën se si Britanikët kanë menduar mbi imunitetin e sovranit si një instrument për të kuptuar, duke marrë parasysh diferencat dhe shkëputjen që ne kemi për më shumë se 200 vjet, si dhe një luftë shtatëvjeçare ndërmjet nesh dhe britanikëve?

**Scalia:** Unë nuk do ta bëja. Unë nuk e përdor ligjin Britanik për çdo gjë. Unë e përdor ligjin Britanik për ato elementë të Kushtetutës që janë marrë nga Britania. Fraza “e drejta për tu ballafaquar me dëshmitarin e palës kundërshtare”, kishte një kuptimin për kolonët Amerikanë dhe që të gjithë ata, ishin ngushtësisht të njohur me mikun tim Blackstone. Kështu, për të ditur se çfarë nënkuptonte Kushtetuta në atë kohë, ju duhet të dinit se cili ishte ligji anglez i asaj kohe. Por kjo nuk është kështu për çdo dispozitë të Kushtetutës.

Ajo që ju përmendët mbi sovranitetin, është ndoshta një çështje për të cilën unë do të konsultohesha me ligjin anglez, sepse kur Kushtetuta u hartua në vitin 1787 u kuptua se shtetet mbetën sovranë të ndarë.

**Breyer:** Unë nuk i vë shpesh referencat e materialeve të huaja në opinionet e mia. Këtë e bëj vetëm me rastet kur besoj se një referencë do t'i ndihmonte juristët, specialistët, ose edhe publikun e gjerë për të kuptuar më mirë çështjen, a pikëpamjet e shprehura në opinionet e mia. Nëse materialet e huaja kanë pasur një impakt të rëndësishëm tek mendimet e mijë, ato mund të bëhen pjesë e opinionit, sepse një opinion duhet të jetë transparent. Duhet të reflektojë mendimin tim aktual.

**Pyetje:** Gjyqtari Scalia ka ngritur shqetësimin, duke e sjellë në qendër të vëmendjes, se citimi i ligjit të huaj është një ftesë për elitat juridike që të imponojnë moralin dhe pikëpamjet e tyre sociale. Por, ende asnjë prej gjyqtarëve, as Gjyqtari Scalia

dhe as Gjyqtari Breyer, nuk kanë prekur një shqetësim më të madh në lidhje me këto materiale. Konkretisht, nuk ka fare të bëjë me imponimin e elitës si e tillë, por ka të bëjë me faktin se këto materiale ligjore nuk kanë origjinë demokratike, nuk kanë lidhje demokratike me këtë sistem ligjor, me këtë sistem kushtetues, kështu u mungon përgjegjësia demokratike. Më lejoni që ta drejtoj këtë si një pyetje.

**Scalia:** Ato janë materialet e tua. Ti duhet t'i mbrosh ato. [Të qeshura.]

**Breyer:** Kjo pikë është interesante. Është e zakonshme për një opinion që t'i referohesh një materiali, i cili siç e përshkruat edhe ju, nuk ka “origjinë demokratike.” Blackstone nuk kishte ndonjë origjinë demokratike. Profesorët e drejtësisë nuk kanë origjinë demokratike. Përsëri unë lexoj dhe iu referohem traktateve dhe artikujve që rishikojnë ligjet. Opinioni im nënkupton një reflektim të metodës sime aktuale se si arrij në konkluzionin ligjor.

Por pyetja juaj ka një domethënie interesante edhe më të thellë. Ngandonjëherë është e vështirë për ata që jetojnë në vendet e huaja, të themi evropianët, që të kuptojnë se si amerikanët mund të reagojnë në mënyrë kaq negative ndaj nocionit që edhe gjyqtarët e huaj mund të shkruajnë opinione, të cilat mund të ishin detyruese për amerikanët. Ata mund të besojnë që në një kuptim, një gjykatës është po aq i mirë sa edhe një tjetër. Është e vërtetë që unë kam ngritur pak a shumë një pikë të ngjashme duke sugjeruar se ngandonjëherë—e theksoj fjalën “ngandonjëherë”—nuk ka asgjë të keqe nëse shikon opinionet e gjyqtarëve të huaj.

Megjithatë, Madisoni ka theksuar se Kushtetuta Amerikane është një “Kartë e Pushtetit të dhënë nga Liria dhe jo një Kartë e Lirisë e dhënë nga Pushteti.” Duke thënë këtë ai theksonte se, qeverisja jonë kombëtare qëndron tek teoria “i gjithë pushteti e ka origjinën nga populli”. Çfarëdolloj pushteti që zotëron qeveria, ajo e zotëron përmes delegimit nga njerëzit. Por në shumë vende të huaja, pushteti qeverisës buron nga autoriteti qendror, ndoshta nga mbreti dhe në këtë çast, një qeveri e zgjedhur dhe liria, reflekton një delegim të lirisë nga ky autoritet qendror. Origjinat e pushtetit dhe të lirisë ndryshojnë në mënyrë konceptuale, edhe nëse të dyja nocionet përfundojnë në të njëjtin vend.

Për këtë arsye amerikanët kanë një lloj të menduari që, në lidhje me ushtrimin e pushtetit nga dikush, pyesin: “Kush është ky person? Çfarë pushteti kam unë, çfarë pushteti ka populli amerikan duke e autorizuar këtë person që të ushtrojë pushtet mbi mua?” Kur unë dëgjoj kritika mbi pikëpamjet e mija që bazohen mbi këtë botëkuptim, unë nuk ankohe. Edhe në qoftë se unë nuk jam dakord me kritika të caktuara, kjo reflekton një parim që është i shëndetshëm dhe i rëndësishëm. Ky parim, në të cilin amerikanët besojnë fort, është “i gjithë pushteti duhet të dalë nga populli dhe populli duhet të mbajë kontrollin mbi ushtrimin e pushtetit”. Kjo është një gjë e mirë.

Ky parim, sigurisht, kur zbatohet siç duhet, nuk më ndalon mua që ngandonjëherë, të marr në konsideratë opinionet e huaja dhe me raste madje, edhe t’i citoj ato.

**Dorsen:** Gjyqtari Scalia.

**Scalia:** Mendoj se do të ishte shumë mirë që ta mbyllnim me diçka për të cilën ne padyshim, biem dakord. [Të qeshura.]

**Tiranë, 2014**

**Me mbështetjen e Programit të USAID-it për  
Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (JuST)**

**Përshtati: Prof. Dr. Aurela Anastasi**